
PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Upgrade i Infrastrukturës CCTV dhe Implementimi i DRS (Disaster Recovery Site)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Paketa software dhe sisteme informacioni
- Paketa software për industri specifike.
- Paketa software për përmirësim sistemesh operativ
- Paketa software për sisteme networking

VLERA E FONDIT LIMIT: 42.500.000 lekë pa TVSH (dyzet e dy milionë e pesëqind mijë lekë pa TVSH)/ 460.155,92 (katërqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e pesë presje nëntëdhjetë e dy) euro pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (tre vitet e fundit) 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se fondi limit për këtë procedurë prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter është vendosur në mënyrë që të garantohet një nivel i pranueshëm në lidhje me eksperiencën, besueshmërinë, përvojën në kontrollin e llogarive të entiteteve të krahasueshme.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entitet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit Udhëzim i Përgjithshëm, nr. 26, datë 8.9.2023 për tatimin mbi të ardhurat, Ligj nr. 29/2023 për tatimin mbi të ardhurat. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e furnizimeve të furnizuara, Faturat të jene te deklaruar ne organet tatimore.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e furnizimeve të furnizuara. Faturat të jene te deklaruar ne organet tatimore.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori ekonomik duhet te kete personel te kualifikuar per realizimin e projektit.Per plotesimin e kesaj kerkese ofertuesi duhet te paraqese certifikaten e kerkuara per :
 - a) ISO 9001:2015: Per menaxhimin e cilesise;
 - b) ISO 20000-1:2018: Per menaxhimin e sistemeve te informacionit;
 - c) ISO 27001:2022 Per menaxhimin e sigurise se informacionit;

Certifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 te VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të

punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi:

- **Duke qene se paisjet te cilat do te instalohen jane per sistem sigurie si dhe teknologjia e kerkuar eshte e nje niveli te larte duhet qe subjektet zbatuese te kontrates te jene te pajisura me keto certifikime.**
 - *Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operationale të nevojshme për të zbatuar kontratën.*
 - *Përmbushja e standartit **ISO 9001** është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.*
 - *Certifikimi **ISO 27001** shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës duke siguruar që informacionet të menaxhohen në mënyrë të sigurtë duke qene se sistemi perpunon dhe administron informacione dhe te dhena te rëndësishme dhe sensitive . Ky certifikim garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standartet nderkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës.*
 - *Certifikimi **ISO 20001-1** shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës duke qenë se zotëron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke garantuar zbatimin me korrektesi te kontrates si dhe kryerjen e instalimeve per pajisjet respektive. Ky certifikim garanton gjithashtu Autoritetin Kontraktor se shërbimet e ofruara gjatë zbatimit të kontratës janë sipas standarteve ndërkombëtare për menaxhimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit.*
3. Operatori Ekonomik ofertuese duhet të jete i autorizuar për furnizimin dhe suportin për pajisjet e ofruara, për këtë duhet të paraqesin Autorizimin nga prodhuesi / Distributori i autorizuar nga prodhuesi (ne rastin e distributorit te autorizuar duhet te paraqitet dokumenti qe verteton lidhjen midis Prodhuesit dhe distributorit) për furnizimin dhe suportin në territorin e Shqipërisë të materialeve sipas listës së materialeve për pikat : 1, 2, 3, 5, 6,7,8,9,10, 11, 12, 13, 14, 15 ,16, 17, 22

Argumentimi:

Autorizimi i prodhuesit/distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar për territorin e Shqipërisë për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanton që produktet që kërkohen të blihen janë prodhuar/krijuar sipas standardeve të larta nga prodhues të njohur zyrtarisht. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për të garantuar që Operatori Ekonomik ka mbështetjen dhe suportin e prodhuesit për të garantuar

cilesine e produkteve dhe furnizimin e tyre ne kohe për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e pajisjeve ne kushtet e garancisë dhe pas saj.

4. Operatori Ekonomik duhet te kete te punesuar jo me pak se 10 punonjes ne listepagese, nga te cilet te pakten 3 nga keta punonjes duhet te jene te diplomuar si inxhinjer Elektronik/ Informatik/ Kompjuterik/Telekomunikacioni dhe 1 (një) punonjes i diplomuar si Inxhinjer Elektrik. Per keta punonjes duhet te paraqiten Diplomat dhe duhet qe te figurojne ne liste pagesat e 3 muajve te fundit.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Argumentimi :

Duke qene se instalimi do te kryhet me pajisje sigurie te sistemeve te ndryshme te cilat jane te shtrira ne territor kerkohet qe OE qe do te zbatoje kontraten te kete staf te mjaftueshem dhe te kualifikuar per realizimin ne kohe dhe me cilesi te larte te kontrates.

5. Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht **1 (nje) punonjes te trainuar dhe certifikuar nga Prodhuesi per Ndertimin e Sistemeve te Integruar** per produktet qe do te ofertohen. Per kete duhe te paraqese certifikaten perkatese. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.

Argumentimi:

Eshte kerkuar ky kriter pasi eshte shume i rendesishem per faktin qe me Upgrade te sistemit BVMS kerkohet te integrohen sistemi i Alarmit dhe Sistemi i Akses kontrollit te kabinave elektrike duke e bere nje sistem kompleks dhe shume sensitiv dhe qe kerkon kualifikim te larte te konfirmuar nga prodhuesi per instalimin dhe garantimin e funksionimit te sistemeve.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

6. Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht **2(dy) punonjes te trainuar dhe certifikuar nga prodhuesi per Sistemet e Menaxhimit te Videos** per produktet qe do te ofertohen. Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.

Argumentimi :

Ky kriter eshte shume i rendesishem pasi sistemi CCTV menaxhohet dhe administrohet nga nje platforme egzistuese e cila edhe me Upgrade qe do ti behet sistemit kerkon njohje shume te mira dhe te konfirmuar nga prodhuesi per te

garantuar upgrade dhe menaxhim te mire te sistemit video . Per kete kerkohet qe konfigurimet dhe instalimet te behen nga punonjes te kualifikuar nga prodhuesi.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

7. Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht **2 (dy) punonjes te certifikuar per instalimin, programimin dhe mirembajtjen e sistemeve CCTV**. Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.

Argumentimi..

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe komponentët e tij. Pajisjet e kerkuara jane pjese e sistemit CCTV per kete duhet qe operatori te kete punonjes te trajnuar dhe te certifikuar per instalimin, programimin dhe mirembajtjen e sistemeve CCTV

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

8. Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht **2 (dy) punonjes te certifikuar per instalimin, programimin dhe mirembajtjen e sistemeve Network**, Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.

Argumentimi:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe komponentët e tij. Paisjet dhe Sistemi funksionojne ne nje rrjet Network, per kete duhet qe operatori te kete punonjes te trajnuar dhe te certifikuar per rrjetet Network.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

9. Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht **1 (nje) punonjes qe eshte i certifikuar per Sigurine Kibernetike** .Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.

Argumentimi:

Pajisjet e kerkuara prodhojne, transmetojne dhe administrojne informacione te rendesishme dhe sensitive te cilat kerkojne nje sistem dhe administrim te sigurte te te gjitha te dhenave. Me kete kriter kerkohet te garantohet siguria e informacionit nga nderhyrje kibernetike te qellimshme apo aksidentale. Per kete kerkohet qe instalimi te monitorohet dhe kontrollohet nga punonjes te kualifikuar dhe certifikuar per sigurine kibernetike.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

10. Operatori ekonomik duhet te kete **1(nje) punonjes pergjegjes te certifikuar per sigurine dhe shendetin ne pune.** Per kete duhet te paraqese certifikaten perkatese

Argumentimi :

Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë, kështu qe nje përgjegjës eshte i nevojshem për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

11. Operatori ekonomik duhet te kete **2 (dy) punonjes instalator te pajisur me kartela te sigurimit teknik** nga ISHTI ose institucione ekuivalente te licensuara.

Argumentimi:

4 (kater) punonjes te pajisur me kartela te sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente te licensuara, jane gjykuar te nevojshem duke vleresuar llojin e punimeve , kushtet e ambienteve dhe vendeve ku behet instalimit i paisjeve te cilat jane te ekspozuara nga reziqe te caktuara. Keta punonjes duhet te jene te paisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik duke qene se punimet do te kryhen ne teren dhe ne kushte specifike ku kerkohet zbatimi i rregullave te sigurise.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

12. Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht **2 (dy) punonjes te certifikuar per punime ne lartesi.** Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.

Argumentimi:

Paisjet telekamera PTZ pjese e ketij prokurimi montohen ne Kullat metalike egzistuese ne lartesi deri ne 40 mt. Instalimet ne keto struktura te larte jane te ekspozuara nga veshpiresi dhe reziqe te ndryshme. Per kete kerkohet qe operatori ekonomik te kete punonjes te certifikuar per punime ne lartesi, per te garantuar instalimin e paisjeve ne keto kushte si dhe sigurine e vete punonjesve.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

13. Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht **1 (një) punonjes te certifikuar per Sisteme Radar nga prodhuesi per produktin qe do ofertohe**t. Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.

Argumentimi :

Radar sigurie eshte nje paisje e gjenerates se fundit dhe i nje teknologjie te larte, per kete eshte shume e rendesishme qe operatori ekonomik te kete punonjes te kualifikuar per garantimin e implementimit me sukses te paisjes, integrimin me kamerat PTZ si dhe garantimin e konfigurimit dhe funksionimit korekt te Radarit.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

14. Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht **1(nje) punonjes te trainuar dhe certifikuar nga prodhuesi per sistemet e Alarmit**. Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.

Argumentimi :

Sistemet e Alarmit jane te instaluara ne nyje shume sensitive per sistemin e shperndarjes se energjise si dhe rjetit network data dhe video, per kete kerkohet qe keto sisteme te jene te integruara ne sistemin BVMS. Per kete duhet qe operatori ekonomik te kete punonjes te kualifikuar nga prodhuesi per sistemet e alarmit per garantimin e realizimit te integrimin me sukses.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

15. Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht **1(nje) punonjes te trainuar dhe certifikuar nga prodhuesi per sistemet e Akses Kontrollit**. Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.

Argumentimi :

Sistemet e Akses Kontrollit jane te instaluara ne nyje shume sensitive per sistemin e shperndarjes se energjise si dhe rjetit network data dhe video, per kete kerkohet qe keto sisteme te jene te integruara me sistemin BVMS. Per kete duhet qe operatori ekonomik te kete punonjes te kualifikuar nga prodhuesi per garantimin e realizimit te integritimit me sukses.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

16. Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht **1(nje) punonjes te trainuar dhe certifikuar nga prodhuesi per paisje Switch** per produktet qe do te ofertohen. Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.

Argumentimi :

Paisjet Switch ne sistemin e sigurise jane paisje shume te rendesishme per infrastrukturen network dhe kane nje role te rendesishme ne transmetimin e informacionit video dhe data. Per kete kerkohet qe operatori ekonomik te kete punonjes te kualifikuar dhe certifikuar per garantimin e implementimit dhe konfigurimit te paisjes swtch.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

17. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën **1 (një) punonjes të certifikuar që zotëron certifikatën PMP (Project Manager Professional)** të lëshuar nga PMI ose ekuivalent. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.

Argumentimi :

Eshte kerkuar ky kriter pasi eshte shume e rendesishme qe punonjesi qe zotron certifikaten PMP te mundesoje nje administrim te burimeve njerezore si dhe te jete i afte te ndjek dhe garantoje korrordinimin me efikasitet te burimeve te Operatorit per te garantuar perputhjen e veprimtarise me kerkesat e projektit si dhe te Autoritetit Kontraktor.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

18. Operatori ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

N.S - 13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni

N.S - 14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

Argumentimi:

Keto licenca jane te lidhura me natyren dhe llojin e procedures se prokurimit dhe tregojne profesionalizmin dhe aftesine tekniko-profesionale te operatoreve ekonomik per te kryer instalimet e nevojshme.

19. Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Dokumentin e titulluar Ofertë Teknike të ngarkuar në SPE nga Autoriteti Kontraktor në formën e një tablele kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e Listës. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

- Emri i kompanisë prodhuese ose distributor i autorizuar nga prodhuesi me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në dokumentat e ofertimit .Adresa dhe web-sit të sakta të kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar.
- Emërtimi i Katalogut të prodhuesit.
- Nr.i faqes në katalog referuar Nr.Idetifikues të artikullit të ofruar sipas listës i shënuar me një shenjë dalluese.
- Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin katalogët/broshurë për të gjithë mallrat që do të ofertoehen.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6 germa c, si dhe në nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kërkesa për paraqitjen e ofertës teknike dhe katalogëve të paisjeve të sipërcituara i shërben Autoritetit Kontraktor për krijimin e një panorame të qartë mbi përputhshmërinë e produktit/eve dhe specifikimeve teknike të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesmarrës me produktin/tet dhe specifikimet teknike të kërkuara nga AK, pra qëllimi i këtij kriteri është vërtetimi nga ana e operatorit ekonomik se paisja që do të ofrohet i përmbush specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor duke bërë krahasimin ndërmjet tyre.

Sqarim:

Pranohen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një certifikatë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentim për specifikimet teknike

Specifikimet teknike për objektin e kësaj procedure prokurimi janë hartuar në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, në veçanti nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36 të tij, si dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, në veçanti nenin 40, pika 2.

Në zbatim të këtyre dispozitave, specifikimet teknike janë përcaktuar duke përshtetur karakteristikat funksionale, të performancës, sigurisë, kapacitetit, ndërveprueshmërisë dhe kushteve mjedisore që duhet të plotësojnë mallrat dhe shërbimet objekt prokurimi, në atë nivel që konsiderohet i nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Në hartimin e tyre është respektuar parimi që kërkesat teknike duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës, proporcionale me qëllimin e prokurimit, të verifikueshme teknikisht dhe të mos krijojnë pengesa të pajustificuara për konkurrencën.

Objekti i prokurimit lidhet me përmirësimin dhe zgjerimin e një infrastrukture ekzistuese të sigurisë dhe videomonitorimit të Autoritetit Portual Durrës dhe jo me ndërtimin nga e para të një sistemi të ri e të pavarur. Për këtë arsye, një pjesë e kërkesave teknike lidhen domosdoshmërisht me kompatibilitetin, ndërveprueshmërinë dhe integrimin me sistemet ekzistuese, me qëllim ruajtjen e investimit të kryer, shmangien e kostove të panevojshme, vazhdimësinë e shërbimit dhe funksionimin e të gjithë komponentëve si një sistem i vetëm sigurie.

1. Përmirësimi i platformës së menaxhimit të videos – VMS

Kërkesa për përmirësimin e platformës ekzistuese të menaxhimit të videos është përcaktuar nga nevoja për rritjen e disponueshmërisë, sigurisë dhe vazhdimësisë së sistemit aktual CCTV. Sistemi ekzistues i Autoritetit Portual Durrës është i ndërtuar mbi platformën Bosch Video Management System – BVMS, ndaj projekti synon përmirësimin dhe zgjerimin e kësaj infrastrukture, duke ruajtur konfigurimet, pajisjet, kamerat, serverët, VRM-të dhe investimet e realizuara më parë. Kalimi në një version Professional kërkohet, ndër të tjera, për të mundur:

- regjistrimin e dyfishtë të pamjeve;
- realizimin e një site-i rezervë për regjistrim;
- mekanizma më të avancuar të failover-it;
- administrim të centralizuar;
- zgjerim të numrit të kamerave dhe workstation-eve;
- integrim me sistemin radar;
- integrim me sistemet e alarmit dhe kontrollit të aksesit;
- përputhshmëri me infrastrukturën moderne serverike dhe sistemet operative;

- administrim më të sigurt të përdoruesve dhe të drejtave të aksesit.

Kërkesa për kompatibilitet me sistemin ekzistues nuk ka për qëllim favorizimin e një operatori ekonomik, por buron nga kushti objektiv teknik i ndërveprimit me një platformë të instaluar dhe funksionale, shmangia e krijimit të një infrastrukture paralele dhe mbrojtja e investimit ekzistues të Autoritetit Kontraktor.

Në çdo rast, kur në specifikimet teknike referohet një produkt, teknologji, standard apo prodhues konkret, referenca duhet të interpretohet së bashku me termin **“ose ekuivalent”**, në kuptim të nenit 36 të LPP-së, me kusht që zgjidhja ekuivalente të garantojë funksionalitet, performancë, siguri dhe ndërveprueshmëri të plotë me infrastrukturën ekzistuese, pa cenuar funksionimin e saj dhe pa krijuar kosto shtesë të pajustificuara për Autoritetin Kontraktor.

2. Serverët e menaxhimit të sistemit

Parametrat minimalë të serverëve janë përcaktuar duke marrë në konsideratë ngarkesën që krijohet nga administrimi i sistemit VMS, komunikimi me kamerat dhe pajisjet e regjistrimit, përpunimi i eventeve, menaxhimi i përdoruesve dhe integrimi me sistemet e tjera të sigurisë.

Kërkesat për:

- procesor me nivel minimal performance;
- memorie RAM DDR5;
- storage SSD/NVMe në RAID 1;
- dy porta 10 Gigabit Ethernet;
- furnizues energjie redundant/hot-plug;
- instalim në rack;

janë vendosur për të garantuar performancë të qëndrueshme, redundancë, mirëmbajtje pa ndërprerje dhe kapacitet të mjaftueshëm për funksionimin e platformës. Përdorimi i një vlere minimale performance të procesorit, të verifikueshme përmes benchmark-ut publik, synon të përcaktojë nivelin minimal të performancës dhe jo një model të vetëm procesori, duke mundësuar ofrimin e produkteve ekuivalente ose më të mira.

3. Pajisjet Storage 3U dhe 2U

Kërkesat për storage janë përcaktuar duke u nisur nga sasia e të dhënave video që gjenerohet nga kamerat, koha e kërkuar e ruajtjes, bitrate-i i regjistrimit dhe nevoja për vazhdimësi në rast defekti. Konfigurimet RAID 5/RAID 6, disqet e dedikuara për sistemin operativ në RAID 1, furnizuesit redundant hot-swappable dhe kapacitetet e përcaktuara synojnë:

- mbrojtjen nga humbja e të dhënave;
- vazhdimësinë e regjistrimit në rast defekti të një disku;
- zëvendësimin e komponentëve me ndërhyrje minimale;
- rritjen e kapacitetit të ruajtjes;
- shkallëzimin e sistemit në të ardhmen.

Kërkesa për pajisje 2U dhe 3U lidhet gjithashtu me hapësirën fizike të disponueshme në rack dhe me numrin e disqeve që duhet të mbështeten.

4. HDD-të dhe kapaciteti i regjistrimit

Kapaciteti i disqeve dhe numri i tyre është përcaktuar në raport me:

- numrin e kamerave;
- rezolucionin e regjistrimit;
- numrin e frame-ve;
- bitrate-in mesatar;
- periudhën e ruajtjes;
- konfigurimin RAID;
- rezervën e nevojshme të kapacitetit.

Përdorimi i disqeve me kapacitet të lartë redukton numrin fizik të njësive të nevojshme, konsumin e energjisë, kompleksitetin operacional dhe hapësirën e përdorur në rack.

5. Licencat e sistemit, kamerave, workstation-eve dhe Dual Recording

Licencat e përcaktuara në listën e mallrave nuk përbëjnë funksione të shkëputura, por janë të nevojshme për aktivizimin dhe përdorimin e komponentëve të sistemit ekzistues VMS.

Numri prej 150 licencash për kamera lidhet me infrastrukturën e kamerave që duhet të administrohet nga sistemi qendror.

Numri prej 30 licencash Dual Recording është përcaktuar për të mundësuar regjistrimin paralel të 30 kamerave të konsideruara kritike, si në site-in kryesor ashtu edhe në site-in rezervë.

Përzgjedhja e këtyre kamerave do të bëhet në bazë të:

- rëndësisë së zonës së monitoruar;
- riskut të sigurisë;
- rëndësisë operationale;
- nevojës për disponueshmëri të regjistrimeve edhe në rast incidenti në site-in primar.

Licencat për workstation, Advanced Tracking Suite dhe integrimet janë të nevojshme për realizimin e funksioneve operative të parashikuara nga arkitektura e projektit dhe nuk janë kërkesa të shkëputura nga objekti.

6. Kamerat PTZ

Parametrat e kamerave PTZ me zoom të lartë janë përcaktuar duke marrë në konsideratë dimensionet e zonës portuale dhe distancat e mëdha që duhet të monitorohen. Zoom-i optik minimal, ndjeshmëria në ndriçim të ulët, ndriçimi IR, Dynamic Range, funksionet PTZ dhe analiza inteligjente janë të nevojshme për:

- identifikimin dhe ndjekjen e objekteve në distancë;
- monitorimin gjatë natës;
- funksionimin në zona me kontraste të mëdha ndriçimi;
- ndjekjen automatike të personave dhe mjeteve;
- verifikimin vizual të eventeve të sigurisë.

Mbrojtja IP66/IK10 dhe rezistenca ndaj temperaturës, lagështirës, vibrimeve, erërave dhe korrozionit janë përcaktuar duke marrë në konsideratë **kushtet specifike të ambientit portual dhe detar**.

7. Kamerate Bullet

Rezolucioni minimal i kërkuar për kamerat fikse është përcaktuar për të siguruar një nivel të mjaftueshëm detaji në zonat që kërkojnë monitorim të vazhdueshëm. Rezolucioni 4K, teknologjia HDR, analiza video, zoom-i/fokusi i motorizuar, regjistrimi lokal dhe mundësia për funksione analitike mundësojnë përdorimin e kamerave jo vetëm për monitorim të përgjithshëm, por edhe për hetimin e ngjarjeve dhe evidentimin e detajeve të nevojshme. Kërkesat IP/IK janë të domosdoshme për garantimin e rezistencës së pajisjeve ndaj kushteve të jashtme.

8. Kamera PTZ, për zonën e radarit

Kjo kamera është parashikuar si pjesë e integritetit radar–video. Zoom-i optik, saktësia e pozicionimit PTZ, funksionet e tracking-ut dhe mundësia e kontrollit nga platforma e radarit janë të nevojshme që, pas identifikimit të një objekti nga radari, kamera të mund të orientohet automatikisht drejt koordinatave përkatëse dhe të realizojë verifikimin vizual të objektit. Standardi IP68, rezistenca ndaj korrozionit, reshjeve, mjegullës së kripur, temperaturave dhe vibrimeve është përcaktuar për shkak të instalimit të pajisjes në ambient të hapur dhe pranë zonës detare.

9. Sistemi Radar

Sistemi radar kërkohet për zgjerimin e aftësisë së Autoritetit Portual Durrës për monitorimin e basenit dhe zonës perimetrale. Ndryshe nga një kamera konvencionale, radari duhet të sigurojë zbulim dhe gjurmim të vazhdueshëm të objektivave edhe në kushte ndriçimi të dobët ose kushte atmosferike të pafavorshme.

Distancat minimale të zbulimit janë përcaktuar në raport me dimensionet reale të zonës që do të mbulohet dhe synojnë detektimin e:

- personave;
- automjeteve;
- mjeteve detare dhe objektivave të tjera të përcaktuara nga sistemi.

Kërkesa për mbulim jo më të vogël se 127,000 m² dhe fushëpamjen e kërkuar lidhet me sipërfaqen fizike që duhet të mbulohet nga pika e parashikuar e instalimit. Gjurmimi i shumë objektivave në të njëjtën kohë është i nevojshëm për një ambient portual ku mund të ekzistojnë

njëkohësisht disa mjete lundruese dhe objekte në lëvizje. Kërkesat për IP67/NEMA dhe temperaturën e operimit lidhen me instalimin në ambient të jashtëm dhe ekspozimin ndaj kushteve atmosferike. Frekuenca e punës është përcaktuar në funksion të karakteristikave të teknologjisë radar të nevojshme për distancat, saktësinë dhe fushën e mbulimit të kërkuar dhe duhet të jetë në përputhje me kërkesat rregullatore të aplikueshme për përdorimin e frekuencave radio në Republikën e Shqipërisë.

10. Software AI dhe integrimi Radar – Video

Software-i AI kërkohet për të mundësuar një analizë të kombinuar të informacionit të marrë nga radari dhe kamerat. Kombinimi i Radar AI dhe Video AI rrit aftësinë për:

- klasifikimin e objektivave;
- verifikimin e alarmeve;
- reduktimin e alarmeve të rreme;
- prioritizimin e eventeve;
- orientimin automatik të kamerave PTZ;
- ndjekjen e objektivave;
- përcaktimin e zonave dhe niveleve të ndryshme të alarmit.

Kërkesa për integrim përmes formateve dhe ndërfaqeve standarde si JSON, XML, ONVIF dhe web/API synon të mundësojë ndërveprueshmëri dhe të shmangë krijimin e një platforme të izoluar.

11. Serveri AI për menaxhimin e radarit

Serveri/workstation-i AI duhet të realizojë përpunimin e algoritmeve të analizës së videos dhe të të dhënave të radarit në kohë reale. Për këtë arsye janë përcaktuar kërkesa minimale për:

- procesor multicore;
- memorie RAM;
- NVMe storage;
- GPU me aftësi të dedikuara për AI;
- përpunim Tensor ose teknologji ekuivalente;
- ndërfaqe komunikimi dhe API.

Referimi ndaj një arkitekture GPU konkrete ka për qëllim përcaktimin e nivelit minimal të performancës së nevojshme për AI, dhe pranohen teknologji ekuivalente ose më të avancuara që realizojnë të njëjtat funksione dhe performancë.

12. Aksesorët e montimit, ndriçuesi IR, PSU dhe konektorët

Setet e montimit dhe aksesorët janë pjesë integrale e funksionimit të kamerave dhe janë të domosdoshëm për instalimin e tyre në kushtet konkrete të projektit. Kërkesa që aksesorët të jenë të përshtatshëm dhe kompatibël me pajisjet e ofruara synon eliminimin e problemeve të montimit, furnizimit me energji, izolimit, komunikimit dhe humbjes së garancisë. Ndriçuesi IR

është i nevojshëm për realizimin e detektimit në distanca të mëdha gjatë natës. Furnizuesi i energjisë dhe seti IP67 synojnë mbrojtjen e pikave elektrike dhe të komunikimit nga lagështira, pluhuri dhe agjentët atmosferikë.

13. Switch-i 24 porta Gigabit me uplink 10 Gbps

Switch-i është komponent kritik i infrastrukturës së transmetimit të videove dhe të dhënave të sigurisë. 24 portat Gigabit dhe portat uplink 10 Gbps janë përcaktuar duke marrë në konsideratë numrin e pajisjeve që do të lidhen dhe volumin e trafikut video. Funksionet VLAN, QoS, IGMP Snooping, Spanning Tree/Rapid STP, LACP, routing statik dhe funksionet e sigurisë janë të nevojshme për:

- segmentimin e trafikut CCTV;
- izolimin e sistemeve të sigurisë;
- kontrollin e broadcast/multicast;
- redundancën e rrjetit;
- priorizimin e trafikut video;
- mbrojtjen nga akseset e paautorizuara;
- administrimin e centralizuar të rrjetit.

PoE/PoE+ kërkohet për furnizimin e pajisjeve IP direkt nga infrastruktura e rrjetit, duke reduktuar nevojën për instalime elektrike të veçanta.

14. Midspan PoE 95 W

Midspan-i me fuqi deri në 95 W është parashikuar për pajisjet që, për shkak të funksioneve PTZ, ngrohjes, IR-së ose komponentëve të tjerë, kërkojnë fuqi më të lartë sesa pajisjet standarde PoE. Kërkesa për komunikim Gigabit siguron që pajisja të mos krijojë kufizim në transmetimin e trafikut video.

15. Integrimi i sistemeve të alarmit, zjarrit dhe kontrollit të aksesit

Kabinat elektrike përbëjnë nyje kritike të infrastrukturës së sigurisë, pasi në to ndodhen rack-et, switch-et, furnizimet elektrike dhe lidhjet me fibrat optike. Integrimi i sistemeve të:

- detektimit të zjarrit;
- alarmit;
- kontrollit të aksesit;

me sistemin qendror VMS synon që operatori i sigurisë të ketë një pamje të centralizuar të eventeve. Në këtë mënyrë, një alarm zjarri, hapje e paautorizuar apo event tjetër mund të shoqërohet menjëherë me verifikimin përkatës në video, duke ulur kohën e reagimit dhe duke rritur efikasitetin operacional. Kompatibiliteti me sistemet ekzistuese është kërkesë funksionale dhe teknike e domosdoshme për realizimin e këtij integrimi.

16. Data Center-i rezervë dhe lidhjet e komunikimit

Krijimi i një site-i rezervë është parashikuar për të reduktuar riskun që regjistrimet kritike të mbeten të disponueshme vetëm në infrastrukturën kryesore të APD-së.

Në rast:

- defekti të storage-it kryesor;
- incidenti fizik;
- ndërprerjeje energjie;
- problemi teknik;
- cenimi të infrastrukturës lokale;

regjistrimet e kamerave të përzgjedhura duhet të vazhdojnë të jenë të disponueshme në një vendndodhje tjetër. Për këtë arsye Data Center-i rezervë duhet të sigurojë minimalisht:

- monitorim 24/7;
- furnizim redundant me energji;
- UPS dhe gjenerator;
- ftohje redundante;
- kontroll temperature dhe lagështie;
- mbrojtje nga zjarri;
- kontroll fizik të aksesit;
- mbikëqyrje të ambienteve;
- lidhje redundante komunikimi.

Distancimi fizik i site-it rezervë nga infrastruktura primare synon reduktimin e mundësisë që i njëjti incident fizik apo operacional të prekë njëkohësisht të dy site-et. Nga ana tjetër, vendosja e një distance maksimale të arsyeshme lidhet me nevojën për ndërhyrje dhe mirëmbajtje fizike të pajisjeve brenda një kohe të pranueshme.

17. Kapaciteti i linjës së komunikimit

Kapaciteti i linjës së komunikimit ndërmjet APD-së dhe site-it rezervë është përcaktuar në bazë të volumit të trafikut që krijohet nga transmetimi i stream-eve video.

Bandwidth-i i nevojshëm ndikohet nga:

- numri i kamerave;
- rezolucioni;
- frame rate;
- codec-u i përdorur;
- bitrate-i;
- numri i stream-eve;
- trafiku i administrimit dhe playback-ut.

Për këtë arsye është kërkuar kapacitet i garantuar dhe lidhje e dedikuar, në mënyrë që funksionimi i regjistrimit rezervë të mos jetë i varur nga luhatjet e një lidhjeje interneti të zakonshme.

18. Standardet teknike dhe kërkesat për konformitet

Standardet CE, IEC, IEEE, ONVIF, IP, IK, NEMA dhe standardet e tjera të përfshira në specifikimet teknike janë përcaktuar në funksion të natyrës së pajisjeve dhe ambientit ku ato do të instalohen.

Ato synojnë të përcaktojnë nivele minimale të:

- sigurië elektrike;
- ndërveprueshmërisë;
- rezistencës mekanike;
- rezistencës ndaj ujit dhe pluhurit;
- rezistencës ndaj korrozionit;
- komunikimit në rrjet;
- sigurië së pajisjeve.

Referencat ndaj standardeve do të interpretohen në përputhje me nenin 36 të LPP-së, duke u pranuar standardi i referuar ose ekuivalenti i tij, nëse operatori ekonomik provon në mënyrë të përshtatshme se zgjidhja e propozuar siguron nivel të barasvlershëm ose më të lartë të performancës dhe siguriës.

19. Siguria kibernetike

Kërkesat për TPM, PKI, HTTPS, TLS, AES, autentikim, menaxhim të përdoruesve dhe mbrojtje të firmware-it janë përfshirë për shkak se pajisjet objekt prokurimi janë pajisje IP të lidhura me infrastrukturën e teknologjisë së informacionit dhe me sistemet e siguriës fizike të Autoritetit Kontraktor. Komprometimi i një kamere, serveri, switch-i ose sistemi tjetër sigurie mund të ndikojë në konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të gjithë sistemit.

Për këtë arsye kërkesat e siguriës kibernetike janë pjesë funksionale e objektit dhe jo kërkesa formale të shkëputura prej tij.

20. Instalimi, konfigurimi, integrimi dhe testimi

Kërkesa për instalim dhe konfigurim nga operatori ekonomik është e nevojshme pasi objekti nuk konsiston vetëm në furnizimin fizik të pajisjeve.

Operatori ekonomik duhet të realizojë:

- instalimin;
- konfigurimin;
- integrimin;

- migrimin;
- konfigurimin e regjistrimit rezervë;
- konfigurimin e rrjetit;
- integrimin e radarit dhe kamerave;
- integrimin me sistemet ekzistuese;
- testimin funksional;
- kalimin në prodhim.

Para pranimit përfundimtar duhet të verifikohet funksionimi i sistemit në tërësi dhe jo vetëm funksionimi individual i pajisjeve. Kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me qëllimin e kontratës, pasi vetëm pas integritetit dhe testimit mund të konsiderohet se zgjidhja e prokuruar përmbush funksionet për të cilat është realizuar investimi.

21. Garancia minimale 2-vjeçare

Garancia minimale dyvjeçare është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën dhe rëndësinë e pajisjeve që prokurohen, të cilat do të funksionojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe në kushte të vështira ambientale. Garancia synon të mbrojë Autoritetin Kontraktor nga shpenzime të parakohshme për defekte prodhimi ose funksionimi dhe të sigurojë që investimi të mbështetet teknikisht gjatë periudhës fillestare të përdorimit. Kërkesa konsiderohet proporcionale me natyrën e mallrave dhe rëndësinë e sistemit për sigurinë dhe vazhdimësinë operationale.

Përmbledhje

Në përfundim, specifikimet teknike janë hartuar mbi bazën e nevojave reale funksionale dhe operative të Autoritetit Portual Durrës, konfigurimit të infrastrukturës ekzistuese, kushteve specifike të ambientit portual, kërkesave për vazhdimësi operationale, siguri fizike dhe siguri kibernetike. Parametrat minimalë të përcaktuar nuk kanë për qëllim kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, por sigurimin që pajisjet dhe zgjidhjet e ofruara të realizojnë funksionet për të cilat kryhet prokurimi dhe të jenë teknikisht të përshtatshme për integrim me infrastrukturën ekzistuese. Në zbatim të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, çdo referencë ndaj një standardi, marke, tipi, teknologjie, prodhuesi apo origjine specifike, për rastet kur një referim i tillë është teknikisht i domosdoshëm për përshkrimin e objektit ose për evidentimin e kompatibilitetit me sistemin ekzistues, do të kuptohet e shoqëruar me termin “ose ekuivalent/e”.

Ekuivalenca do të vlerësohet mbi bazën e karakteristikave objektive teknike dhe funksionale, performancës, sigurisë, ndërveprueshmërisë dhe aftësisë së produktit apo zgjidhjes së propozuar për të realizuar të njëjtin funksion ose një funksion më të mirë, pa cenuar funksionimin dhe sigurinë e infrastrukturës ekzistuese të Autoritetit Kontraktor. Për rrjedhojë, specifikimet teknike konsiderohen të lidhura me objektin e kontratës, proporcionale me nevojat e Autoritetit Kontraktor, objektivisht të justifikuar dhe të hartuara në përputhje me parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, transparencës dhe konkurrencës, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik.